


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER IRENA R. LAHA
ADRESA Nr.7,Rr."Muhedin
Llagami",Pall.VALA, KT. 1
TEL: 682023915



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 91


Nr. koleksioni: 41

Tirane më 20/03/2024

13

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024052520002836103

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



Taksa e pullës u pagua.

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

TË SHOQËRISË SALI ELEKTRIK SH.P.K

Sot, më datë 20.03.2024, para meje Notere IRENA R. LAHA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Nr.7, Rr."Muhedin Llagami", Pall.VALA, KT. 1, u paraqitën personalisht:

SHITES:

Refat Sali, atësia Veip, amësia Tati, shtetas Shqiptar, lindur në Varosh, Vlorë dhe banues në TIRANË, me adresë Naim Frashëri; Nd. 24; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 26/08/1959, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033677028 dhe nr. personal F90826091J, në cilësinë e ortakut të shoqërisë SALI ELEKTRIK Sh.p.k, regjistruar si person juridik në datën 17.10.2007, me nr. Unik identifikimi të subjektit NUIS K72217008P, me seli në Durrës, lagja 14, Rruga "Dëshmorëve", pranë Qendres Galaktik.

BLERES:

Bardhyl Sali, atësia Veip, amësia Tati, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Sami Frasher; Nd. Pall.22; H. 1; Ap. 10; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë 5; 0000; Tiranë, lindur më 13/09/1963, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036481369 dhe nr. personal G30913062V, në cilësinë e ortakut të shoqërisë SALI ELEKTRIK Sh.p.k, regjistruar si person juridik në datën 17.10.2007, me nr. Unik identifikimi të subjektit NUIS K72217008P, me seli në Durrës, lagja 14, Rruga "Dëshmorëve", pranë Qendrës Galaktik.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë SALI ELEKTRIK Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Neni 1

Shitësi Refat Sali është ortak me 40% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë SALI ELEKTRIK Sh.p.k, regjistruar si person juridik në datën 17.10.2007, me nr. Unik identifikimi të subjektit NUIS K72217008P, me seli në Durrës, lagja 14, Rruga "Dëshmorëve", pranë, Qendres Galaktik.

Këto kuota të shoqërisë Shitësi ia shet Blerësit i cili pranon t'i blejë ato sipas kushteve të përcaktuara më poshtë në këtë kontratë.

Neni 2

2.1 Çmimi i shitjes së kuotës në pronësi të Shitësit Refat Sali, e cila përfaqëson 40% të kapitalit themeltar të shoqërisë SALI ELEKTRIK Sh.p.k., është në vlerën nominale prej 40.000.000 (dyzetë milion) lekë.



A2024052520002836103

- 2.2 Blerësi Bardhyl Sali, ortakutjetër i shoqërisë SALI ELEKTRIK Sh.p.k , blen kuotën që shet Shitësi Refat Sali, e cila përfaqëson 40% të kapitalit të shoqërisë SALI ELEKTRIK Sh.p.k, në vlerën nominale prej 40.000.000 (dyzetë milion) lekë.
- 2.3 Me shitjen e kësaj kuote, përbërja e ortakëve në shoqërinë SALI ELEKTRIK Sh.p.k. ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

Z. Bardhyl Sali bëhet ortakut i vetëm i shoqërisë SALI ELEKTRIK Sh.p.k dhe zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 3

- 3.1 Me realizimin e kësaj shitblerje të 40% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë SALI ELEKTRIK SHPK. Blerësit i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja, ndërsa Shitësi largohet nga pjesëmarrja e mëtejshme në këtë shoqëri dhe nuk ka detyrime ndaj të tretëve.

Neni 4

- 4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotën që i transferon Blerësit; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e saj apo që t'i ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi të deri në datën e sotme; ai e shet këtë kuotë të kapitalit të shoqërisë Blerësit të lirë nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi të nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloj natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi kuotën.

Neni 5

- 5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.
- 5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 5.3 Kontrata merr fuqi ligjore me likuidimin e vlerës prej 40.000.000 (dyzetë milion) lekë, nga pala blerëse Bardhyl Sali, në favor të palës shitëse z. Refat Sali, nëpërmjet transfertës bankare pranë INTESA SAN PAOLO BANK sha, me nr.llogarie AL59208260260000064001435103, brenda datës 10.04.2024. Mandati do të bashkëlidhet me kontratën.

Në këtë kontratë është prezent dhe jep pëlqimin e saj dhe bashkëshortja e shitësit znj.Xhuljeta Sali e bija e Omer-it, lindur në Vlorë, datl.16.02.1966, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Letërnjftimi me numër 034244164 dhe numër personal G65216073U.

Bashkëlidhur kësaj kontrate:

Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese; Ekstrakti i QKB-së; Vendimi i Asamblesë dt.19.03.2024; Mandat pagesa, Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë; Çertifikatë familjare e palës Shitëse.

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) ekzemplarë me të njëjtën vlerë ligjore dhe palët pasi e lexuan dhe e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë e nënshkruajnë pa vërejtje para meje noteres, prandaj dhe unë e vërtetoj atë në bazë të Ligjit Nr.110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".



A2024052520002836103

PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

REFAT SALI

Refat Sali

Dhënëse e pëlqimit, bashkëshortja
e shitësit:

Xhuljeta Sali

Xhuljeta Sali

[Signature]

BLERËSI

BARDHYL SALI

Bardhyl Sali

NOTER

Irena R. Laha

Irena R. Laha

